



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1755/prot.
2

Gramsh më , 05.05.2026

VENDIM

Nr.30, datë 30. 04. 2026

**“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
‘KODRIONI’ SH.P.K.,
MIRATIMIN E STATUTIT DHE AKTIT TË THEMELIMIT”**

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 8, pika 2, dhe nenit 9, pika 1/1.6, shkronja “b”, si dhe neneve 23, 26 dhe 33, pika 1, shkronja “d”; të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, konkretisht neni 54, shkronja “d”; të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar; të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”; si dhe të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Gramsh, në datën __.04.2026, për shqyrtim dhe miratim projekt-aktin përkatës.

Vendosi:

1. Të miratojë ne parim krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të quajtur ‘KODRIONI’ sh.p.k., me kapital fillestar me një vlerë prej **10 000 Leke, me objekt veprimtarie siç përshkruhet ne aktin e themelimit (Neni 4 i Aktit), bashkëlidhur këtij vendimi.**
2. Bashkia Gramsh është zotëruese e 100% të kuotave, të cilat përbëjnë kapitalin e themeltar të ‘KODRIONI’ sh.p.k., me një vlerë prej 10 000 Leke, **e barabartë me 1 (Një) kuotë.**
3. Të miratojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë ‘KODRIONI’ sh.p.k bashkëlidhur këtij vendimi Shtojca nr. 1.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Gramsh ose personi i autorizuar prej tij të përfaqësojë Bashkinë për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për themelimin e shoqërisë ‘KODRIONI’ sh.p.k sipas përcaktimeve të pikës 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.
5. Kryetari i Bashkisë Gramsh brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi në përputhje dhe me parashikimet e ligjit Nr.9901, data 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

- emëron administratorin e shoqërisë.
6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 10.000 (Dhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2026 dhe Bashkia Gramsh e transferon këtë shumë pranë kësaj shoqërie, menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Bashkia Gramsh brenda 15 (Pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë 'KODRIONI' shpk, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 7. Shoqëria 'KODRIONI' sh.p.k, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vleresojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëri të tjera tregtare dhe të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me persona të tretë.
 8. Bashkia Gramsh i siguron shoqërisë 'KODRIONI' sh.p.k, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambiente të tjera të kontraktura ndaj të tretëve, mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë sipas objektit të saj.
 9. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Finances, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
 10. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan.

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI





1755/3

05.05.2026.

mungon fagio 3.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "KODRIONI" SH.P.K.

Sot më date ____ . ____ .2026, Shoqëria "KODRIONI" Sh.p.k., me adresë, sheshi "Kamber Dërmynshi" Godina e Bashkisë Gramsh, pajisur me NUIS _____, në cilësinë e ortakut të vetëm, me zotërues 100% të kuotave "Bashkia Gramsh", përfaqësuar nga kryetari i Bashkisë Gramsh, Z.Besion Ajazi, shtetas Shqiptar, me adresë Lagjja "Sporti", me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me nr.ID I50705083B.

Në mbështetje të dispozitave të ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 "Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar; Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 "Pë mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar; Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, miratohet statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KODRIONI" sh.p.k., krijimi dhe funksionimi i së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

1. Shoqëria do të quhet "KODRIONI" sh.p.k., person juridik publik, e cila do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 2

Adresa dhe Forma Ligjore e Shoqërisë

1. Forma ligjore e Shoqërisë është "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", me 1 (një) ortak të vetëm, themeluesin e saj Bashkia "Gramsh" përfaqësuar nga z.Besion Ajazi.
2. Ortaku i vetëm "Bashkia Gramsh" do të përgjigjet për detyrimet e shoqërisë dhe do të mbulojë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
3. Shoqëria do të ketë selinë qendrore të saj në adresën: në sheshin "Kamber Dërmynshi", Godina e Bashkisë Gramsh, kati i III.
4. Ortaku i vetëm mund të vendosi mbi transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër.

Neni 3

Kohëzgjatja e Aktivitetit të Shoqërisë

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe Pa afat.
2. Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Asambles së Përgjithshme për shpërndarjen e shoqërisë, ose kur shpërndarjen e saj e përcakton vetë legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

1. Shoqëria "KODRIONI" sh.p.k., ka për objekt të aktivitetit të saj si më poshtë vijon:
 - a) Shfrytëzimin e pyjeve, grumbullimin e lëndëve drusore, përpunimin si dhe tregëtimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
 - b) Grumbullimin e bimëve medicinale, përpunimin si dhe tregëtimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
 - c) Agroturizëm, guida turistike si dhe shërbime hotelerie.
 - d) Implementimin e pajisjeve të qëndrueshme ekologjike për rikuperimin, riciklimin, trajtimin, asgjësimin e mbetjeve dhe të materialeve që rrjedhin prej tyre.
 - e) Menaxhimi i tregjeve të lira, përmirësimi, mirëmbajtja dhe administrimi i tyre.
 - f) Ndërtimin dhe menaxhimin e parqeve fotovoltaike, hidrocentraleve, prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.
 - g) Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e lulishteve, parqeve dhe hapësirave të gjelbra;
 - h) Rehabilitimin e hapësirave të gjelbra në territorin e Bashkisë Gramsh nëpërmjet mbjelljes së pemëve dhe bimëve;
 - i) Furnizimin me bimësi dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi, për zonat e banuara, segmentet rrugore, kopshtet, çerdhet, shkollat publike;
 - j) Grumbullimin e materialeve inerte, prodhimin e tubave të betonit (Tombino) të dimensioneve të ndryshme dhe tregëtimin e tyre.
 - k) Menaxhimin e hapësirave të parkimit publik me pagesë në territorin e bashkisë, duke ofruar lehtësi në parkimin e mjeteve për qytetarët.
 - l) Menaxhimi i tregjeve të lira, përmirësimi, mirëmbajtja dhe administrimi i tyre.
2. Shoqëria mund të nënshkruajë kontrata apo të jetë palë kontraktuese me subjekte privat apo publikë, në lidhje me kryerjen e shërbimeve sipas objektit të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Neni 5

Vula e Shoqërisë

1. Shoqëria identifikohet me vulën e saj, përmbajtja e së cilës është si më poshtë vijon: "KODRIONI" sh.p.k, si dhe ne baze te Niptit te saj e cila do te rigjenerohet nga sistemi informatik i QKB.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

1. Kapitali themeltar i shoqërisë “KODRIONI” sh.p.k., është 10 000 Lekë, i përbër nga kapital në para/naturë. Zotërues me 100% të kuotave të shoqërisë “KODRIONI” sh.p.k., është Bashkia Gramsh.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet dhe/ose zvogëlohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, duke reflektuar në statut ndryshimet përkatëse. Për zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë do të repektohen dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 7

Mënyrat e Fitimit dhe Kalimit të Kuotave

1. Kuotat e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo tjetërsohen nëpërmjet:
 - kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - shitblerjes;
 - trashëgimisë;
 - dhurimit;
 - çdo mënyre tjetër që parashikohet me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- 3.

Neni 8

Organet e Shoqërisë

1. Organet e shoqërisë “KODRIONI” sh.p.k., janë:
 - 1.1. Asambleja e Përgjithshme;
 - 1.2. Administratori.Administratori i shoqërisë është Z. _____, shtetas Shqiptar, me adresë _____, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Nr.ID _____.
2. Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme me qëllim për të arritur përmbushjen e objektit të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim ai mund t’u drejtohet palëve të treta për ndihmë, të cilëve mund t’u delegojë tërësisht apo pjesërisht një sërë kompetencash për realizimin e objektit të saj.
3. Administratori është i autorizuar të përfaqësojë dhe të nënshkruajë për shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj (Ligji Nr.9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”), e në veçanti nga dispozitat e nenit 81 të këtij ligji, të drejtat e ortakut të vetëm të shoqërisë, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "g" dhe "h" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
4. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - e) Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit
5. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Neni 10

Thirrja dhe Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nga ortaku i vetëm i saj.
2. Asambleja mund të thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Ky njoftim duhet të përmbajë të dhënat sipas parashikimeve të nenit 83 i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
3. Asambleja e përgjithshme mer vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të votave që parashikohet në nenin 86 dhe 87 të ligjit.
4. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
5. Mbledhja e Asamblesë drejtohen nga ortaku i vetëm i saj.

Neni 11 **Administratori**

1. Asambleja e përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë për një periudhë **5-Vjeçare** në pajtim me nenin 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
2. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
3. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
 - a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatite dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryej regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, administratori është i detyruar të thërrasin asamblesë e përgjithshme.
5. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.
6. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
7. Ndryshimet e statutit nga Asambleja e Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë akte të mëparshme të administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

Neni 12 **Shpërbërja e Shoqërisë**

1. Shoqëria shpërbëhet në rastet që parashikohen në Statut dhe sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Neni 13 **Likuidimi i Shoqërisë**

1. Kur shoqëria prishet ajo kalon në ‘Likuidim’ dhe në këtë rast emërtimit të shoqërisë i shtohet shënimi ‘Shoqëri në likuidim e sipër’.
2. Shoqëria dhe gjatë procesit të likuidimit do të vazhdojë të qëndroj si person juridik deri në përfundimin e procesit të likuidimit.

3. Shpërbërja e shoqërisë do të sjellë pasoja ndaj të tretëve vetëm pas publikimit të ç'regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 14

Dispozita të Fundit

1. Ndryshimet në Aktin e Themelimit të Shoqërisë do të bëhen vetëm me vendim me shkrim të Asambles së Përgjithshme të Aksionerëve.
2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim.
3. Nëse mosmarrëveshjet nuk arrihen të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë do të zgjidhen nga gjykata kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Për aq sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
5. Statuti u hartua në gjuhën Shqipe në 5 kopje, u lexua dhe u nënshkrua nga ortaku i vetëm i shoqërisë "KODRIONI" sh.p.k., zotërues i 100% të kuotave.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË "KODRIONI" SH.P.K.

BASHKIA "GRAMSH"

Përfaqësuar nga z. Besion AJAZI





1755/4
05.05.2026.

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “KODRIONI” sh.p.k .

Sot më datë 04 . 2026, Shoqëria “KODRIONI” Sh.p.k., me adresë në sheshin “Kamber Dërmyshi”, Godina e Bashkisë Gramsh, kati i III, pajisur me NUIS _____, në cilësinë e ortakut të vetëm, me zotërues 100% të kuotave “Bashkia Gramsh”, përfaqësuar nga Administratori, Z. _____, shtetas Shqiptar, me adresë _____, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me nr. ID _____,

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 8, pika 2, dhe nenit 9, pika 1/1.6, shkronja “b”, si dhe neneve 23, 26 dhe 33, pika 1, shkronja “d”; të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, konkretisht neni 54, shkronja “d”; të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar; të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”; si dhe të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar;; ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, miratohet akti i themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “KODRIONI” sh.p.k., krijimi dhe funksionimi i së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

1. Shoqëria do të quhet “KODRIONI” sh.p.k., person juridik publik, e cila do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Neni 2

Adresa dhe Forma Ligjore e Shoqërisë

1. Forma ligjore e Shoqërisë është “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, me 1 (një) ortak të vetëm, themeluesin e saj Bashkia “Gramsh” përfaqësuar nga z.Besion Ajazi, shtetas Shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Shoqëria do të ketë selinë qendrore të saj në adresën: në sheshin “Kamber Dërmyshi”, Godina e Bashkisë Gramsh, kati i III.
3. Ortaku i vetëm mund të vendosi mbi transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjetër.

Neni 3

Kohëzgjatja e Aktivitetit të Shoqërisë

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe te pa caktuar.
2. Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme për shpërndarjen e shoqërisë, ose kur shpërndarjen e saj e përcakton vetë legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

1. Shoqëria "KODRIONI" sh.p.k., ka për objekt të aktivitetit të saj si më poshtë vijon:

- a. Shfrytëzimin e pyjeve, grumbullimin e lëndëve drusore, përpunimin si dhe tregëtimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
- b. Grumbullimin e bimëve medicinale, përpunimin si dhe tregëtimin e tyre brenda dhe jashtë vendit.
- c. Agroturizëm, guida turistike si dhe shërbime hotelerie.
- d. Implementimin e pajisjeve të qëndrueshme ekologjike për rikuperimin, riciklimin, trajtimin, asgjësimin e mbetjeve dhe të materialeve që rrjedhin prej tyre.
- e. Menaxhimi i tregjeve të lira, përmirësimi, mirëmbajtja dhe administrimi i tyre.
- f. Ndërtimin dhe menaxhimin e parqeve fotovoltaike, hidrocentraleve, prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.
- g. Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e lulishteve, parqeve dhe hapësirave të gjelbra;
- h. Rehabilitimin e hapësirave të gjelbra në territorin e Bashkisë Gramsh nëpërmjet mbjelljes së pemëve dhe bimëve;
- i. Furnizimin me bimësi dhe mirëmbajtjen e tyre në vazhdimësi, për zonat e banuara, segmentet rrugore, kopshtet, çerdhet, shkollat publike;
- j. Grumbullimin e materialeve inerte, prodhimin e tubave të betonit (Tombino) të dimensioneve të ndryshme dhe tregëtimin e tyre.
- k. Menaxhimin e hapësirave të parkimit publik me pagesë në territorin e bashkisë, duke ofruar lehtësi në parkimin e mjeteve për qytetarët.
- l. Menaxhimi i tregjeve të lira, përmirësimi, mirëmbajtja dhe administrimi i tyre.

2. Shoqëria mund të nënshkruajë kontrata apo të jetë palë kontraktuese me subjekte privat apo publikë, në lidhje me kryerjen e shërbimeve sipas objektit të ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Neni 5

Vula e Shoqërisë

1. Shoqëria identifikohet me vulën e saj, përmbajtja e së cilës është si më poshtë vijon: "KODRIONI" sh.p.k.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

1. Kapitali themeltar i shoqërisë "KODRIONI" sh.p.k., është 10 000 Lekë, i përbërë nga kapital në para. Zotërues me 100% të kuotave të shoqërisë "KODRIONI" sh.p.k., është Bashkia "Gramsh".
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet dhe/ose zvogëlohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, duke reflektuar në statut ndryshimet përkatëse. Për zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë do të repektohen dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 7

Organet e Shoqërisë

1. Organet e shoqërisë "KODRIONI" sh.p.k., janë: